



Në mbështetje të nenit 2 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për Policinë, Nr. 04/L-076, të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 04/19 Mars 2012, Ministri i Punëve të Brendshme, nxjerr

KODIN E ETIKËS TË POLICISË

I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kodi i Etikës të Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kodi i Etikës) përfaqëson standarde morale dhe etike të Policisë, shpreh vullnetin dhe dëshirën e zyrtarit policor për veprim ligjor, profesional, të drejtë, kompetent, korrekt dhe njerëzor.
2. Qëllimi i Kodit të Etikës është ngritja e vetëdijes të zyrtarit policor për rëndësinë e respektimit të parimeve etike dhe forcimi i sjelljes etike dhe morale në praktik.
3. Shtojcë e Kodit të Etikës është përshkrimi i vlerave dhe cilësive të cilat identifikojnë misionin e Policisë dhe formulari i Kodit të Etikës, të cilin kanë detyrë ta nënshkruaj secili zyrtar policor dhe do të vendoset në dosjen e tij.

Neni 2 Respektimi i personalitetit

1. Zyrtari policor ka për detyrim të siguroj ruajtjen dhe të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Gjatë kufizimit ligjor nga të drejtat dhe liritë, të respektojnë dinjitetin, personalitetin dhe integritetin e çdo personi.
2. Dinjiteti, personaliteti dhe integriteti i çdo personi do të mbrohet duke penguar të ushtrohet torturë, ndëshkim a trajtim mizor, çnjerëzor ose veprime të tjera të cilat janë poshtëruese për njerëz.

II PARIMET THEMELORE

Neni 3 Sjellja e personelit të Policisë

Në kryerjen e detyrave zyrtare, zyrtari i Policisë, është i obliguar të sillet me kompetencë, të veprojë dhe duhet t'i trajtojë të gjithë personat në mënyrë njerëzore, të respektojë dinjitetin dhe personalitetin e çdo personi, si dhe të drejtat dhe liritë themelore, të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe në këtë kod të Etikës së Policisë.

Neni 4 **Respektimi i barazisë para ligjit**

Zyrtari policor, në kryerjen e detyrave zyrtare, kujdeset që të gjithëve iu kanë siguruar të drejta të barabarta dhe liritë themelore pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike ose tjera, fetare ose filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë, pozitës shoqërore ose të ndonjë tjeter vetic.

Neni 5 **Mbrojtja e autoritetit të Policisë**

1. Zyrtari policor, gjatë kryerjes së detyrave zyrtare si dhe sjelljes në jetën private, duhet ta mbrojë, ruajë dhe ta avancojë autoritetin e Policisë. Veçanërisht duhet të kujdeset për forcimin e integritetit të Policisë në tërsësi.
2. Zyrtari policor gjatë zbatimit të autorizimeve, të detyrave dhe procedurave zyrtare në raport me qytetarët, institucionet shtetërore, organizatat jo qeveritare dhe institucione tjera, në punën e tij duhet të jetë parimor, të veprojë me vendosmëri por njëkohësisht të jetë i përbajtur, i kujdeshëm, të mos cenojë nderin e prestigjin dhe të mos i shqetësojë pa nevojë ose mos t'i imponojë atyre obligime të panevojshme. Vëmendje të veçantë zyrtari policor duhet t'i kuştojë personave që kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes të shtuar.

Neni 6 **Kundërshtimi i korruptionit**

Zyrtari policor duhet të jetë i paanshëm, i sjellshëm, profesional, i vendosur dhe imun dhe të kundërshtojë të gjitha format e korruptionit. Zyrtari policor nuk ka privilegje dhe as nuk i kërkon ato për vete apo për dikë tjetër. Me vendosmëri duhet ta denoncojë dhe lajmërojë ryshfetin dhe çdo formë të korruptionit.

Neni 7 **Publiciteti i punës**

Nëpërmjet punës publike, të ligjshme, të ndershme, të sjellshme, të paanshme, transparente, të guximshme dhe profesionale, zyrtari policor përfiton vullnetin e mirë të qytetarëve dhe njëherë pranon qytetarët si një formë kontrolli për punën e tij.

Neni 8
Profesionalizmi, arsimimi dhe pavarësia

1. Zyrtari policor duhet të jetë i arsimuar – edukuar për përbushjen profesionale të detyrave dhe për këtë t'i nënshtrohet trajnimt profesional.
2. Zyrtari policor ka të drejtë t'i bashkohet një sindikate ose organizate profesionale.
3. Zyrtari policor nuk duhet të jetë nën ndikim të ndonjë partie politike dhe, performanca profesionale e zyrtarit policor nuk mund të varet nga bindjet e tij politike e as nga pikëpamjet e tij.

Neni 9
Mbrojtja dhe ruajtja e të dhënavë

1. Zyrtari policor ka për detyrë t'i mbrojë dhe t'i ruajë të dhënat dhe informacionet që konsiderohen si sekrete dhe të dhënat tjera të besueshme që i ka mësuar gjatë detyrës ose edhe jashtë saj në mënyrë të rastësishme.
2. Detyrimi i ruajtjes së të dhënavës të besueshme dhe i materialeve nga paragrafi 1 i këtij nenit do të vazhdojë edhe pasi t'i ndërpritet marrëdhënia e punës zyrtarit policor.

Neni 10
Respektimi i ndërsjellë

Veprimet dhe marrëdhëniat ndërmjet zyrtarëve policorë mbështeten në respektimin e ndërsjellë, ndihmë reciproke dhe solidare, kolegjalitet, tolerancë, sinqueritet, besimit reciprok dhe krenarisë, kritikës dashamirëse dhe komunikim të mirë.

Neni 11
Respektimi i kodit të Etikës

Zyrtari policor duhet të veprojë në përputhje me kodin e Etikës, për çka është informuar me përbajtjen e tij dhe është i vetëdijshëm për përgjegjësinë dhe pasojat morale në rast të shkeljes së kodit të Etikës.

III OBJEKTIVAT DHE BAZA LIGJORE

Neni 12
Objektivat

1. Objektivat kryesore të Policisë së Kosovës janë:

- 1.1. Të mbrojë jetën, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat;
 - 1.2. Të mbajë rendin dhe sigurinë publike;

- 1.3. Të parandalojë dhe zbulojë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- 1.4. Të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- 1.5. T'i trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët pa dallim race, ngjyre, religjioni, gjinie dhe moshe;
- 1.6. Të kryej funksione të ndihmës dhe shërbimeve për qytetarët.

Neni 13
Statusi i policisë

1. Policia e Kosovës është shërbim publik i themeluar në bazë të ligjit.
2. Të gjitha veprimet dhe operacionet policore duhet të zhvillohen gjithnjë në përputhje me legjislacionin vendas dhe standardec ndërkontaktuale të pranuara nga Kosova.

Neni 14
Legjislacioni

1. Legjislacioni i Policisë duhet të jetë në dispozicion për qytetarët, i qartë dhe i saktë në nivelin e duhur, i mbështetur me rregulla të qarta, të cilat rregulla duhet të jenë gjithashtu edhe për qytetarët të qarta.
2. Personeli policor i nënshtronhet të njëjtit legjislacion si qytetarët e rëndomtë dhe përjashtim janë vetëm rastet e justifikuara me arsyet e punës policore në një shoqëri demokratike.

IV. ROLI I POLICISË NË SISTEMIN E DREJTËSISË DHE MARRËDHËNIET E NDËRSJELLTA

Neni 15
Roli, respektimi i pavarësisë

1. Duhet të ketë dallim të qartë midis rolit të Policisë dhe Prokurorisë së Shtetit, gjyqësorit dhe sistemit të burgjeve. Policia nuk duhet të ketë funksione kontrolluese ndaj këtyre organeve.
2. Policia duhet të respektojë me rrëptësi pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave. Në veçanti, Policia nuk duhet të ngrejë kundërshtime ndaj gjykimeve të ligjshme cse vendimeve gjyqësore dhe as të pengojë zbatimin e tyre.

Neni 16
Funksionet e deleguara

Si rregull i përgjithshëm, Policia nuk ka funksione gjyqësore. Çdo delegim i kompetencave të organeve të drejtësisë Policisë, duhet të jetë i kufizuar dhe në përputhje

me ligjin. Çdo person duhet të ketë të drejtë të ankohet te autoritetet gjyqësore për një veprim, vendim ose mosveprim të Policisë, që cenon të drejtat e individëve.

Neni 17 Bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit

Duhet të ketë bashkëpunim funksional dhe në nivelin e duhur midis Policisë dhe Prokurorisë së Shtetit. Kur Policia vepron nën autoritetin e Prokurorisë së Shtetit në çështje hetimore, duhet të marrë udhëzime të qarta për prioritetet e politikës hetimore të krimeve si dhe për kryerjen e hetimeve penale në rastet përkatëse. Policia duhet të informojë vazhdimisht autoritetet me të larta të hetimeve të veprave penale për zbatimin e udhëzimeve të tyre si dhe, në veçanti, të raportoje rregullisht për ecurinë e procedimeve penale.

Neni 18 Respektimi i rolit të avokatit

Policia duhet të respektojë rolin e avokatëve mbrojtës në procesin e drejtësisë penale dhe, kur është e nevojshme, të ndihmojë individët të marrin ndihmë ligjore në mënyrë të efektshme, veçanërisht në rastin e personave të privuar nga liria.

V STRUKTURA ORGANIZATIVE E POLICISË

Neni 19 Organizimi i policisë

1. Policia është e organizuar në mënyrë të tillë që të gëzojë respektin e publikut si një strukturë profesionale për mbrojtjen e ligjit dhe sigurimin e shërbimeve për qytetarët. Struktura organizative e Policisë funksionon në bazë të dy niveleve të organizimit: në nivelin qendror dhe në nivelin lokal (niveli lokal përfshin edhe nivelin rajonal).
2. Organizimi i Policisë bëhet sipas sistemi të quartë të komandimit brenda Policisë. Duhet të jetë gjithnjë e mundshme të vërtetohet se tek cili epror qëndron përgjegjësia për veprimet ose mosveprimet e personelit të Policisë.

VI MARRËDHËNIA E PUNËS

Neni 20 Kriteret e punësimit

1. Personeli policor i çdo niveli duhet të punësohet mbi bazën e kualifikimeve, përvojës së tij personale dhe meritave të cilat duhet të jenë në përputhje me objektivat e Policisë.
2. Procedurat e punësimit duhet të bazohen në kritere objektive dhe jo diskriminuese, të cilat zbatohen pas verifikimit të nevojshëm të kandidatëve, duke përfshirë kontrollimin

mjekësor. Përveç kësaj Policia, do të synoje të punësojë meshkuj dhe femra nga shtresa të ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë grupe të pakicave etnike, me qëllim që përbërja e personelit policor të reflektojë shoqërinë së cilës ata i shërbejnë.

Neni 21 Përdorimi i forcës

Gjatë ushtrimit të autorizimeve, zyrtari policor ligjërisht ka të drejtë ta përdorë forcën, e cila duhet të jetë e arsyeshme, proporcionale dhe e domosdoshme. Autorizimi për përdorimin e forcës duhet të shfrytëzohet si mjet i fundit dhe vetëm për të arritur një objektiv ligjor të Policisë.

Neni 22 Refuzimi i urdhërave kundërligjor

1. Zyrtari policor duhet të zbatoj me rigorozitet urdhrat e dhëna nga mbikëqyrësi, por gjithashtu duhet të ketë të drejtë të mos zbatojnë urdhra të cilat janë qartësish të paligjshëm dhe të njoftojë për këto urdhra pa pasur frikë se do të ndëshkohet.

2. Kur prej zyrtarit policor kërcohët kryerja e detyrës që është në kundërshtim me rregulloret apo autorizimet e tij, ai është i obliguar ta refuzojë detyrën dhe të veprojë sipas rregulloreve që e rregullojnë këtë fushë. Zyrtarit policor nuk mund t'i imponohet kryerja e një detyrë të tillë, t'i shqiptohet ndonjë masë disiplinore ose sanksion tjetër për shkak të refuzimit të kryerjes së ndonjë akti kundërligjor.

VII TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ZYRTARIT POLICOR

Neni 23 Të drejtat e zyrtarit policor

Si rregull, zyrtari policor duhet të gëzojë të njëjtat të drejta civile dhe politike si qytetaret e tjerë. Kufizime të këtyre të drejtave mund të bëhen vetëm kur është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Policisë në një shoqëri demokratike, kur ato janë në përputhje me ligjin, konventat dhe instrumentet ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave është Kosova.

Neni 24 Organizata përfaqësuese

Zyrtari policor duhet të gëzojë të drejta sociale dhe politike si nëpunës civil në shkallën më të madhe që të jetë e mundur. Në veçanti personeli policor duhet të ketë të drejtë të organizohet ose të marre pjesë në organizata përfaqësuese (siç është sindikata), të marrë një pagë dhe sigurimet shoqërore të përshtatshme, si dhe të sigurohet me masa të veçanta për shëndetin dhe sigurinë, duke marrë parasysh karakterin e veçantë të punës policore.

Neni 25 Disiplina

Masat disiplinore kundër personelit policor duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit nga një organ i pavarur ose nga një gjykatë (masat e shqiptuara nga Komisioni Brendshëm Disiplinor duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit nga Komisioni për Ankesave dhe Shpërblime i cili merr vendim, ndërsa në rastet e caktuara, vendimi përfundimtar merret nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë). Menaxhmenti Policor dhe autoritetet publike duhet të mbështesin personelin policor kur ai/ajo bëhet objekt i akuzave të pabaza lidhur me detyrat e tij/saj.

Neni 26 Pa anshmëria

Zyrtari policor nuk duhet të jetë nën ndikim të ndonjë partie politike, performanca profesionale e zyrtarit policor nuk mund të varet nga bindjet e tij politike e as nga pikëpamjet e tij. Ndërrimi i partive politike në pushtet nuk duhet të ndikojë në profesionalizmin e Policisë. Zyrtari policor ka të drejtë t'i bashkohet një sindikate ose organizate profesionale.

Neni 27 Parandalimi i korruptionit

Në të gjitha nivelet e organizimit dhe strukturat e Policisë, parashikohen masa të efektshme për të parandaluar dhe luftuar korruptionin në radhët e Policisë. Rol të veçantë duhet të ketë Drejtoria e Standardeve Profesionale dhe Njësia e Auditimit dhe Inspektimit të brendshëm.

Neni 28 Marrëdhëniet reciproke

Marrëdhëniet ndërmjet zyrtarëve policor janë të bazuara në përcaktimin e rendit hierarkik, të respektit, ndihmës, solidaritetit të ndërsjellë, kolegjalitetit e shoqërimit, tolerancës, sinqueritetit, besimit dhe dinjitetit të dyanshëm. Këto inkurajojnë dialog të dyanshëm dhe profesionalizëm të lartë në profesionin e zyrtarit policor. Në marrëdhëniet e brendshme nuk mund të zënë vend dukuritë si poshtërimi, nënverësimi dhe përbuzja.

Neni 29 Puna dytësore

Zyrtari policor mund të kryej punë të pavarur shkencore dhe pedagogjike në fushën e botimeve nga lëmi i sigurisë. Me leje me shkrim të mbikëqyrësit si dhe aprovim nga menaxhmenti për autorizim të punës dytësore, zyrtari policor mund të kryejë punë dytësore, si punë plotësuese jashtë Policisë, nëse këto punë nuk përkojnë me punët policore dhe nuk ulin prestigjin e Policisë.

VIII TRAJNIMI I ZYRTARIT POLICOR

Neni 30 Trajnimi policor

Zyrtari policor duhet të jetë i arsimuar – edukuar për përmbushjen profesionale të detyrave dhe për këtë t'i nënshtronhet trajnimit profesional. Trajnimi policor i cili do të bazohet në vlerat themelore të demokracisë, shtetit ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, do të realizohet në përputhje me objektivat e Policisë. Trajnimi i përgjithshëm i zyrtarëve të Policisë, sa më shumë që të jetë e mundur, do të jetë i hapur ndaj shoqërisë.

Neni 31 Trajnimet periodike

1. Trajnimi i përgjithshëm fillestar, është mirë të pasohet me trajnime periodike, pa shkëputje nga puna, kur është e nevojshme trajnimi i specializuar për drejtim dhe udhëheqje.
2. Njësitë përkatëse për trajnim në të gjitha nivelet, e veçanërisht Departamenti i Trajnimeve, duhet të ketë rolin kryesor në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky nen.
3. Në trajnimin e zyrtarëve të Policisë në të gjitha nivelet, duhet të përfshihet trajnimi praktik për përdorimin e forcës dhe kufizimet e saj, duke marre parasysh parimet e të drejtave të njeriut, të sanksionuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me legjislacionin tjeter në fuqi nga kjo fushë.

IX HETIMET

Neni 32 Parimi i pafajësisë

Policia duhet të ndjek parimet sipas të cilave çdo person i akuzuar për vepër penale do të konsiderohet i pafajshëm deri në momentin kur shpallet fajtor nga gjykata, dhe se çdo person i akuzuar për një vepër penale ka disa të drejta, veçanërisht të drejtën për t'u informuar menjëherë për akuzën kundër tij/saj dhe të përgatisë mbrojtjen e tij/saj personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore që ai/ajo e zgjedhë vetë.

Neni 33 Hetim objektiv

Hetimet e Policisë duhet të janë objektive dhe të paanshme. Policia duhet t'i marrë parasysh dhe t'i përshtatet nevojave të veçanta të personave, si fëmijët, të rinjtë, gratë, pakicat duke përfshirë pakicat etnike dhe personat në rrezik.

X DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34 Vlefshmëria

Parimet e përcaktuara me këtë Kod të Etikës zbatohen në të gjitha rastet e kryerjes së detyrave zyrtare policore nga të gjithë zyrtarët e Policisë.

Neni 35 Programi mësimor

Parimet e këtij Kodi janë pjesë e programit mësimorë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Neni 36 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij kodi të Etikës, shfuqizohet parimi P – 1.14 - Kodi i Etikës i Policisë së Kosovës, i muajit Tetor 2009.

Neni 37 Shtojcat e kodit të Etikës

1. Shtojcat që i janë bashkëngjitur këtij Kodi të Etikës, janë pjesë e tij.

- 1.1. Shtojca 1: formulari për njoftim;
- 1.2. Shtojca 2: deklarata e misionit.

Neni 38 Hyrja në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri i Punëve të Brendshme.

Z/ Skender HYSENI

Ministër i Punëve të Brendshme

Datë: 12 / 11 / 2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Njoftim për Kodin e Etikës

Unë, _____ pranoj se gjatë trajnimit themelor në
(shëno emrin dhe mbiemrin)

Akademinë e Kosovës për Siguri Publike jam njoftuar, i kam mësuar dhe jam pajisur me njohuritë për standarde morale dhe etike të Policisë, të cilat edhe i kam kuptuar plotësisht. Me nënshkrimin e këtij njoftimi, pajtohem dhe shpreh vullnetin dhe dëshirën për rëndësinë e respektimit të parimeve etike dhe forcimi i sjelljes etike dhe morale në praktik, gjatë punës sime si zyrtar policor dhe në jetën private.

Në betimin e dhënë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, solemnisht kam dekluaruar se në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim, do të zbatoj Kushtetutën, ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret e Policisë, se do t'i kryej detyrat e mia me profesionalizëm, ndershmëri dhe përgjegjësi.

I ndërgjegjishëm për rëndësinë e punës policore dhe përgjegjësisë time ligjore si zyrtar policor, deklaroj se udhërrëfyes gjatë punës sime do tëjenë zbatimi i plotë i standardeve më të larta etike dhe morale, për të cilat jam betuar kur iu kam bashkëngjitur Policisë së Kosovës.

Departamenti/Drejtoria/Njësia/Sektori: _____;

Nënshkrimi i zyrtarit policor : _____, nr. i kart. ident. _____;

Grada: _____;

Vendi: _____;

Data: ____ / ____ / ____



POLICIA E KOSOVËS DEKLARATA E MISIONIT

TË OFROJ ZBATIM TË LIGJIT NË KOSOVË NË MËNYRË
PROFESIONALE, EFEKTIVE DHE EFIKASE.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

- TË MBROJ JETËN DHE PRONËN
- TË MBAJ RENDIN DHE QETËSIN PUBLIKE
- TË PARANDALOJ DHE ZBULOJË KRIMIN
- TË MBROJE TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT
- T'I TRAJTOJË NË MËNYRË TË BARABARTË TË GJITHË QYTETARËT PA DALLIM, RACË, NGJYRE, RELIGJIONI, GJINIE DHE MOSHE.

VIZIONI

- TË OFROJË PËR KOSOVËN NJË SHËRBIM POLICOR KOMPETENT NË TË GJITHA ASPEKTET E PRIORITETËVE STRATEGJIKË TË TIJ, TË BESUAR NGA POPULLI I KOSOVËS DHE KRENAR PËR PËRFORMANCËN E TIJ.

VLERAT

- NDERSHMËRIA
- INTEGRITETI PROFESIONAL
- KURAJA
- PËRGJEGJËSIA
- LLOGARIDHËNIA
- VETËPËRMBAJTJA